

**Njoftim i përqendrimit ndërmjet Juropan Media Servises Singl Member S.A. Greqi dhe Grik Jelou Pejxhes Printed end Elektronik Informejshn, Greqi**

**(lënda nr. 08-145/2023)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 05.10.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Junajted Media S.a.r.l. me seli të regjistruar në Rue Zhan Mone 6, L-2180 Luksemburg ("Junajted Media") dhe Hostafrano Limited, me zyra në Arh. Makariou III, 58, IRIS TOUER, kati i 8-të 1075 Nikozia, Qipro ("Hostafrano"), nëpërmjet një shoqërie nën kontrollin e tyre të përbashkët Juropan Media Servises Singl Member S.A. me zyrën e saj të regjistruar në Kifisia, Atikë, 36 Viltanioti Strit, Greqi ("EMSA"), mbi shoqërinë Grik Jelou Pejxhes Printed end Elektronik Informejshn S.A. me seli të regjistruar në adresën 26-28 Georgiu Averof Strit, 142 32 Nea Ionia, Atika, Greqi ("Grik Jelou Pejxhes").

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

**EMSA** është një shoqëri nën kontrollin e përbashkët të shoqërive Junajted Media dhe Hostafrano. Shoqëria EMSA është një shoqëri Holding dhe nuk ka realizuar të ardhura të pavarura në vitin e kaluar.

**Junajted Media** është tërësisht në pronësi të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimi ndërkombëtar me bazë në Londër. Fondet e BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të biznesit të kompanive ku investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura në mënyrë indirekte:

- TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në BulevarDIN VMRO nr. 3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor,
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Orce Nikolov 68/3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitete të marketingut, gjegjësisht me blerje dhe shitje të hapësirës reklamuese në media të shkruara dhe elektronike, dhe
- UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Partizanski odredi. 14, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor.

**Hostafrano** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila është themeluar dhe funksionon në përputhje me ligjet e Qipros. Aktivitetet e Hostafrano janë të kufizuara në zotërimin e pjesëve në shoqëri të tjera.

**Grik Jelou Pejxhes** merret me publikimin e listave të emrave telefonike lokale ("faqet e bardha"), versionet online të listave të emrave telefonike dhe faqeve të internetit ("faqet e verdha") me informacione për personat juridikë dhe sipërmarrësit të destinuara për konsumatorët, si dhe shitjen e hapësirës reklamuese në internet. Grik Jeloi Pejxhes është një platformë për promovimin dhe reklamimin e shoqërive tregtare dhe sipërmarrësve dhe një burim i besueshëm informacioni për numrat e telefonit dhe adresat e internetit për pjesëmarrësit e pranishëm në tregun grek.

Grik Jeloi Pejxhes është ekskluzivisht e pranishme në tregun e Greqisë, nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit si tregje relevante për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përkufizohen si: tregu i listave të emrave telefonik lokal ("faqet e bardha"), treg i listave të emrave

telefonik online dhe listave të emrave të faqeve të internetit ("faqet e verdha") me informacione për personat juridikë dhe sipërmarrësit të destinuara për konsumatorët, si dhe shitjen e hapësirës reklamuese në internet në internet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

16.10.2023

Shkup